



**BASHKIA E TIRANËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr.18, datë 19. 03. 2015

**PËR**

**DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I TIRANËS STJEPAN MESIC, ISH  
PRESIDENT DHE KRYEMINISTËR I KROACISË**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim Relacionin “Për dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës, Stjepan Mesic, ish President dhe Kryeministër i Kroacisë”, si dhe mbështetur në nenin 7, pika 2, nenin 8/VII dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar)

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë propozimin për dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës, Stjepan Mesic, ish President dhe Kryeministër i Kroacisë, me motivacionin:

*“Për mbështetjen e madhe që i ka dhënë çështjes kombëtare Shqiptare dhe kontributin e veçantë për nxitjen e bashkëpunimit mes vendeve të Rajonit”*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ALDRIN DALIPI**